

**ALBANA MEMA****ASPEKTE TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE  
POLITIKE NË SHQIPËRI GJATË VITIT 1922**

Pas stabilizimit të statusit juridik të shtetit shqiptar, me deklaratën e Fuqive të Mëdha të 9 nëntorit 1921, në Shqipëri, ashpërsohet lufta për pushtet. Politikanë, intelektualë e nacionalistë, vunë në funksionim mekanizmat e marrjes së pushtetit në forma legjitime dhe jo legjitime. Për këtë u përdorën kauza ose parulla të tilla si: çështja e Kosovës, çështja e reformave, evropianizimi i vendit, reforma agrare, madje një çështje më vete, ishte dhe rrëzimi i Ahmet Zogut, i etiketuar si diktator. Lëvizjet antiqeveritare, shoqëroheshin me ashpërsimin e ballafaqimit politik në parlament ose shtyp, e më pas përfundonin me dyndje kryengritësish të armatosur në Tiranë. Në krye të tyre ishin Elez Isufi, Bajram Curri, Zija Dibra etj., por padyshim, truri i tyre ishin politikanët opozitarë. Ky përfundim bazohet në tonalitetin opozitar në parlament e shtyp ndaj qeverisë konservatore, si dhe në korrespondencën e tyre me mbështetësit respektivë. Të gjitha këto lëvizje, kishin karakter antiqeveritar, në kuptimin që synonin rrëzimin nga pushteti të forcave politike që qeverisnin Shqipërinë, edhe pse këto ishin të zgjedhura rregullisht nga votuesit.

Trazirat politike të dhjetorit të vitit 1921, si dhe vendimet e marra nga Parlamenti e qeveria kundër organizatorëve të grushtit të shtetit,<sup>1</sup> krijuan një pakënaqësi të madhe në radhët e kundërshtarëve të Zogut. Këto vendime, sado të moderuara që ishin, shërbyen si shkaqe kryengritjesh antiqeveritare. Kontingjenti kryesor i këtyre lëvizjeve mbetën ish kundërshtarët e vendosur të Ahmet Zogut. Ndër më kryesorët ishin Bajram Curri, Elez Isufi e Halid Lleshi, të cilët së bashku me fuqitë e tyre u angazhuan në një kryengritje të re.<sup>2</sup>

Faktorë kryesorë politikë në mbështetje të tyre ishin, grupi i politikanëve kosovarë dhe një pjesë e politikanëve shkodranë, të cilët

<sup>1</sup> Lidhur me këtë çështje shih: Albana Mema, "Fillimet e demokracisë institucionale në Shqipëri në vitet 1920-1921", *Studime Historike*, 3-4, Tiranë: 2013, f. 101-128.

<sup>2</sup> Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", 1928, f. 97.

ishin të pakënaqur me shumicën qeverisëse të asaj kohe. Nismën e mori grupimi i kosovarëve, të cilët dolën më të dëmtuarit politikisht prej ngjarjeve të dhjetorit 1921, pasi ata, nëpërmjet Hasan Prishtinës, ishin përfshirë drejtpërdrejt në grushtin e shtetit. Edhe Sejfi Vllamasi ka pohuar të njëjtën gjë por, ai veçon dhe iniciatorët e kësaj kryengritjeje dhe komenton profilin politik të krerëve të saj. Ai shkruan: “Pasi grushti i shtetit dështoi, koalicioni opozitar filloi të përgatisë një kryengritje në stil të gjerë, nën maskën e zgjedhjes së një asambleje kushtetuese. Këtë kryengritje e bëri pjesa ekstremiste e opozitës, Mustafa Kruja me Zija Dibrën”. Këta të fundit Vllamasi i ka cilësuar si “pararojat më guximtare të opozicionit, elementët që dispononin fuqira personale”. Për Bajram Currin ai theksonte se ishte i gënjyer, Elez Jusufi, Hamit Toptani, përfaqësonin bejlerët e mëdhenj dhe Halit Lleshi “ishte vegël e Jugosllavisë”. Të gjithë të lartpërmendurit, sipas Vllamasit, ishin bashkuar për rrëzimin e qeverisë, ndonëse kishin qëllime të ndryshme.<sup>3</sup>

Megjithëse Parlamenti dhe qeveria u treguan tolerantë ndaj organizatorëve të grushtit të shtetit, kundërshtarët e qeverisë së Xhaferr Ypit, që mbështetej nga “popullorët”, nuk i hodhën armët. Arsyeja dhe miqtë e kombit shqiptar sugjeronin se për t’u ruajtur e respektuar shteti i ri nevojitej medoemos qetësi dhe bashkim. Përfaqësuesi i Lidhjes së Kombeve, prof. Sederholm, që kishte vëzhguar ngjarjet e dhjetorit dhe kishte marrë pjesë në mbledhjet e Parlamentit në kohën kur diskutohej grushti i shtetit, bënte thirrje për qetësi e bashkim. Ai deklaronte me bindje se “edhe një pushkë po të zbrazet do të shërbente si një shenjë turbullimesh dhe do të ishte një thikë drejt zemrës së atdheut tuaj”.<sup>4</sup>

Autorët e grushtit të shtetit veprimet që mori Parlamenti më vonë i konsideruan në kundërshtim me Statutin e Lushnjës dhe me pretekst, që të respektoheshin vendimet e Kongresit të Lushnjës, kur ende nuk ishte mbushur viti nga zgjedhjet e para parlamentare, kërkonin mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese. Në fakt, ky ishte një justifikim për të vijuar kundërshtimin e armatosur të qeverisë. Pas dështimit të grushtit të shtetit disa deputetë të opozitës, midis tyre edhe Luigj Gurakuqi, iu drejtuan me

<sup>3</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 409-410.

<sup>4</sup> T. Selenica, *Shqipëria më 1927...*, f. 96-97.

një letër B. Currit të cilit i kërkonin që ai së bashku me popullin të rrëzonin qeverinë e Xh. Ypit.<sup>5</sup>

Qeveria filloi çarmatimin e popullsisë civile, i cili u zgjerua veçanërisht pas goditjes së forcave qeveritare në Martanesh nga mbështetësit e Aqif Pashës. Çarmatimi u vlerësua shumë i arsyeshëm nga përfaqësuesit diplomatikë të huaj dhe në fakt ishte thelbësor për stabilizimin e shtetit dhe vendosjen e sundimit të ligjit. Por, ai cenoi shumë shqiptarë, të cilët armëmbajtjen e kishin tashmë një zakon të fortë të trashëguar nga e kaluara. Ndoshta politika e Zogut për çarmatimin, ndonëse ishte e nevojshme, ishte disi e parakohshme dhe në disa mjedise ajo u keqinterpretua si një shenjë se ai po ecte në gjurmët e Esat Pashës dhe se favorizonte aspiratat sllave, kjo edhe për arsye se ai i ishte kundërvënë irredentizmit. Gjithashtu, ai kishte prirje arbitrare në metodat e veta. Ai ishte një prijës malësor dhe për këtë arsye, Bajram Curri, Zija Dibra e të tjerë, tek të cilët, personaliteti kishte më shumë peshë se sa parimet dhe që nuk arritën ose nuk pranuan ta njihnin aftësinë e tij natyrore, ishin xhelozë për pushtetin që ai kishte fituar në vend. Këta burra, në thelb, atdhetarë të ndershëm, e shihnin atë thjesht si një rival ambicioz që dëshironte të vendoste autoritetin e tij mbi ta.<sup>6</sup>

Pak a shumë këtë gjë pohonte edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, i cili që më 27 shkurt, tërhoqi vëmendjen mbi faktin se “po rritej opozita ndaj qeverisë, politika e së cilës, me çarmatosjen me forcë të popullsisë ka sjellë fyerjen e saj dhe se një opozitë aktive po organizohej në Pukë nën drejtimin e Bajram Currit.” Gjithashtu Komisioni njoftonte: “Duket se që në fillim të marsit, kjo lëvizje shpërtheu në provincën e Drinit, ku një numër njerëzish me influencë, nën drejtimin e Elez Isufit, planifikuan rrëzimin e qeverisë. Duket se ata nuk kanë ndjekur një qëllim politik të caktuar, por janë frymëzuar, ashtu si në lëvizje të tjera revolucionare, vetëm nga motivi i ambicieve personale”.<sup>7</sup>

Parlamenti po përgatiste ligjin për të hetuar autorët e grushtit të shtetit, por me qenë se një pjesë e tyre ishin në Parlament, kjo u zvarrit

<sup>5</sup> Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë: GME, 1997, f. 129.

<sup>6</sup> Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 312-313.

<sup>7</sup> *The British National Archives (TNA)*, Foreign Office (më tej: FO) 371/7329, f. 380-382, Raport plotësues i Komisionit të Hetimit në Shqipëri, 13 maj 1922.

shumë dhe një pjesë e kundërshtarëve të qeverisë shkuan në Malësitë e Veriut ku u bashkuan me forcat e Bajram Currit, Elez Jusufit dhe Halid Lleshit dhe po përgatisnin goditjen e armatosur kundër qeverisë. Refugjatët kosovarë dhe çetat e tyre refuzuan t'i bindeshin dhe të pajtoheshin me qeverinë. Ata kishin një kauzë të madhe, të luftonin për çlirimin nga sundimi jugosllav. Por, ky ishte edhe interesi dhe qëllimi i agjentëve italianë, të cilët inkurajonin luftën e tyre, me qëllim që të dobësonin Jugosllavinë. Me të drejtë është pohuar se, në këtë situatë, ishte e vështirë të dalloje nacionalistët e vendosur nga tradhtarët që paguheshin prej italianëve. Bajram Curri, megjithëse ishte i pashkolluar, ishte marrë nga qeveria në shërbimin ushtarak me gradën kolonel dhe ishte dërguar në prefekturën e Kosovës për të siguruar qetësinë e vendit dhe mbrojtjen e kufirit nga trupat jugosllave. Por, ky i fundit, duke u nxitur edhe nga kundërshtarët e qeverisë, me argumentin se do të luftonte për mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese, mbledhi një sërë forcash civile të armatosura dhe në fillim të marsit 1922 marshoi drejt Shkodrës. Ai i kërkoi parisë së qytetit të bashkohej me të për të përmbysur qeverinë. Paria kundërshtoi t'i bashkohej kësaj kryengritjeje, kështu B. Currit iu pre rruga për të marshuar drejt Tiranës dhe qëndroi me forcat e tij në Pukë.

Ndërkohë, në drejtim të Elbasanit mësynë forcat e Halit Lleshit, të cilat u thyen nga forcat qeveritare pa arritur në qytet. Më të suksesshme ishin forcat dibrane, të komanduara nga Elez Isufi, i cili kishte me vete dhe Zija Dibrën e Mustafa Krujën. Ata, duke udhëtuar në fshehtësi arritën pa u diktuar në afërsi të Tiranës. Pasi thyen një kompani xhandarësh në fshatin Valias, e komanduar nga atdhetari i njohur Meleq Frashëri, i cili ra dëshmor, ata hynë në kryeqytet ku u përballën me forcat qeveritare që komandoheshin nga A. Zogu. Luftimet qenë të ashpra dhe të dyja palët pësuan humbje. Në një situatë të nderë e dramatike, Këshilli i Lartë, pjesa kryesore e qeverisë dhe e Këshillit Kombëtar, si dhe shumë zyrtarë të tjerë u larguan për në Elbasan. Ndërkohë nga Shijaku mësyu drejt Tiranës bashkëpunëtori i Esat Toptanit, Hamit Toptani. Gjendja e forcave qeveritare u bë kritike.

Pikërisht në këto momente të rënda ndërhyri ministri britanik Harry Eyres, i cili e bindi Elez Isufin të tërhiqej. Siç shkruan Swire, Eyres ia doli ta bindte këtë malësor të moshuar atdhetar, por të gënjyer, duke i shpjeguar se ai ishte vetëm një instrument i një komploti që nuk paralajmëronte asgjë të mirë për vendin e tij, duke i premtuar

njëkohësisht atij një amnisti në qoftë se ai tërhiqej.<sup>8</sup> Këtë shpjegim e pasuron më tej M. Kruja, i cili pohon se, Elez Aga kishte ngritur krye pasi njerëzit e tij me urdhër të A. Zogut i kishin bërë shërbime shtetit si forca civile për ruajtjen e kufirit prej shkeljeve të serbëve për disa muaj. Ata kërkonin pagesën e vet, pasi siç theksonte Elezi, “ishin të varfër dhe nuk kishin më durim me prit”. Kruja shton se, Zogu pranoi dhe i dorëzoi të nesërmen e marrëveshjes 20 mijë napolona ar nga tridhjetë që kishte kërkuar Elezi. Kështu ishte mbyllur ky konflikt.<sup>9</sup>

Pas kësaj, forcat qeveritare shpartalluan pa shumë vështirësi forcat e H. Toptanit. Kryengritja antiqeveritare dështoi dhe një pjesë e krerëve të saj si Hamit Toptani e Aqif Pasha, u lanë të lirë të largoheshin jashtë shtetit, ndërsa B. Curri e H. Prishtina u arratisën në malësitë e prefekturës së Kosovës. Në këtë koalicion absurd binte në sy bashkëpunimi i Bajram Currit, një atdhetar i shquar në luftën kundër pushtuesve serbë, me agjentin e paguar nga jugosllavët, Halit Lleshi, si dhe me forcat esadiste të komanduara nga Hamit Toptani, për përmbysjen e qeverisë shqiptare. Swire ka shfaqur dyshimin me vend se, këto lëvizje ishte vështirë të realizoheshin nga burimet e kufizuara që gjendeshin brenda vendit pa financime nga jashtë. Në këtë mënyrë, Shqipëria shpëtoi edhe një herë, nga një rebelim i rrezikshëm, i cili mund të kishte rezultuar shkatërrimtar për shtetin e ri.

Rebelimi i armatosur antiqeveritar i marsit 1922, është trajtuar në mënyrë tendencioze nga një pjesë e madhe e historiografisë shqiptare, duke u paraqitur si një lëvizje demokratike e drejtuar kundër klikës së Zogut dhe forcimit të pozitive të tij autoritariste. Është paraqitur si një argument justifikues për kryengritjen, çarmatimi i popullsisë që filloi qeveria duke e vlerësuar atë si një masë antipopullore, që dëmtonte interesat kombëtare.<sup>10</sup> Megjithatë, as këto historianë, nuk e kanë mohuar se në këtë kryengritje u përfshinë elementë karrieristë esadistë si H. Toptani dhe agjentë të Jugosllavisë e Italisë si H. Lleshi e M. Kruja. Këta të fundit, e kanë argumentuar shpërthimin e kryengritjes me hezitimin e qeverisë për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, e cila “do të mundësonte zhvillimin demokratik të vendit”, si dhe me “masat e ashpra” që ishin marrë para grushtit të shtetit të dhjetorit 1921, me masat e forta për

<sup>8</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 314.

<sup>9</sup> Mustafa Kruja, *Anthologji historike*, Elbasan: Sejko, 2001, f. 300-301.

<sup>10</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 184-186.

mbledhjen e taksave dhe çarmatimin e popullsisë. Këta autorë, ashtu si dhe historiografia e mëparshme i kanë dhënë rebelimit antiqeveritar një mbështetje që, sipas tyre, vinte nga “shumica e popullsisë”.<sup>11</sup>

Edhe Arben Puto e ka parë këtë rebelim si një lëvizje me përkrahje masive, që të mos lejohej vendosja e diktaturës së një oligarkie apo personi, të shkaktuar nga kundërshtimi i thirrjeve për mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese. Por, ai ka shtuar si shkak tjetër, valën e re të tendencave irredentiste të B. Currit, H. Prishtinës, H. Kadriut etj., të cilët, sipas tij, me anë të organizimit të kësaj kryengritjeje, shpresonin të ndikonin në politikën e shtetit shqiptar për ta mbajtur gjallë çështjen e Kosovës.<sup>12</sup> Ndonëse Puto nuk bën asnjë vlerësim, është qartësisht e kuptueshme se, një politikë irredentiste aktive në atë kohë ishte jo vetëm e pamundur, por edhe e rrezikshme. Nuk ishte vetëm Zogu, që e kishte këtë pikëpamje realiste, por e gjithë shumica e politikanëve të kohës. Madje, shumë shpejt koha do ta provonte se edhe vetë opozita kur erdhi në pushtet, në qershor të vitit 1924, nuk mundi të bënte diçka më tepër për Kosovën.

Në të gjitha botimet e lartpërmendura është nënvizuar se, ndërhyrja e përfaqësuesit britanik H. Eyres për të bindur E. Isufin të tërhiqej u bë më së shumti për të penguar fuqizimin e influencës italiane në Shqipëri, pasi shumë krerë të kryengritjes ishin nën ndikimin e italianëve dhe për të mbrojtur marrjen e koncesioneve të naftës nga shoqëritë britanike. Pa e përjashtuar tërësisht këtë argument, duhet theksuar se ai nuk ishte kryesori. Mendojmë se Eyres, më së shumti synonte ruajtjen e stabilitetit në vend dhe e shihte këtë si detyrën themelore që duhet të realizonte shteti shqiptar dhe aktorët e tij politikë.

Konkluzionet e mësipërme i përforconte edhe raporti i Eyres për qeverinë britanike. Në raportin që diplomati i lartë britanik nisi në drejtim të Londrës më 16 mars 1922, ndër të tjera, njoftonte se, Elez Isufi nuk ishte i lidhur me krerët e tjerë të kryengritjes dhe po luftonte për interesat e tij personale. Eyres theksonte: “Ndërsa, qeveria po rriste fuqimisht forcat e saj, unë pata një bisedë me Elez Isufin dhe ai ishte gati të pranonte marrëveshjen. Ai mohoi çdo lloj bashkëpunimi me çdo person tjetër dhe tha se kishte vepruar nga inati ngaqë qeveria nuk i kishte paguar shtesat që ai kishte fituar nga ruajtja e kufirit gjatë vitit që kaloi.

<sup>11</sup> *Po aty.*

<sup>12</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 324-326.

Ai nuk kishte si qëllim të hynte në Tiranë, por takimi me Meleq Frashërin e çoi në këtë rrugë. Por, pas shumë bisedash, ai erdhi bashkë me mua pranë Qeverisë, duke rrëfyer gabimet e tij, dha fjalën e tij se do të qëndronte i qetë në të ardhmen dhe iku bashkë me njerëzit e tij me nderimet e luftës.”<sup>13</sup>

Ministri fuqiplotë Eyres shpjegonte qartë edhe motivet pse kishte ndërmjetësuar këtë marrëveshje paqeje midis Elezit dhe qeverisë, duke na ndihmuar kështu të sqarojmë të gjitha keqkuptimet dhe keqinterpretimet që janë bërë rreth kësaj çështje në shumë raste. Ai në formë shfajësimi, pasi kishte vepruar pa pyetur Foreign Office-in, shkruante: “Shpresoj se Zotëria juaj nuk do të mendojë se i kam kaluar kompetencat e mia në këtë rast. Shqipëria nuk është si vendet e tjera, unë isha i vetmi person në vend, të cilit të dy palët do t’i besonin. E mendova si të drejtë t’i jepja mbështetjen time qeverisë, tek e cila jam akredituar dhe gjithashtu të parandaloja nëse ishte e mundur gjakderdhjen dhe shkatërrimin e një pjese të madhe të qytetit. Isha tepër me fat që pata sukses, qeveria dhe populli i Tiranës më shprehën mirënjohjen.”<sup>14</sup>

Po kështu, shtypjen e rebelimit, këta autorë nuk e kanë vlerësuar si një premisë për forcimin e stabilitetit në vend, por si një moment që shënonte forcimin e pushtetit personal të A. Zogut. Kësaj pikëpamjeje, me të drejtë, i kundërvihet studiuesi amerikan B. Fischer, i cili pohon se: “Shtypja e kryengritjes solli rezultate pozitive në vendosjen e rendit e qetësisë në vend, ku për herë të parë pas 500 vjetësh, qeveria qendrore arriti të shtrinte autoritetin në çdo skaj të vendit”.<sup>15</sup> Megjithatë, është e kuptueshme se, për shkak të këtyre ngjarjeve ndikimi i Zogut tani u rrit ndjeshëm dhe ai menjëherë u angazhua për rivendosjen e rendit, ku do të rezultonte tepër i suksesshëm. Vlerësime diametralisht të kundërta kanë bërë historianë dhe politikanë të asaj periudhe, të cilët, e kanë cilësuar kryengritjen, si një rebelim kundër një qeverie legjitime parlamentare dhe me pasoja të rënda për stabilitetin e vendit, ndërsa kërkesën për thirrjen e

<sup>13</sup> FO 371/7331, f. 427-429, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, Durrës, 16 mars 1922.

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 37.

Asamblesë Kushtetuese, si një pretekst të paarsyeshëm për të justifikuar kryengritjen e armatosur.<sup>16</sup>

Interesant është fakti se, këto lëvizje Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve i konsideronte të nxitura nga jashtë vendit. Në raportin e tij thuhej: “Në çdo përpjekje të këtij lloji, ka thashetheme se njëra palë ose tjetra subvencionohet nga para të huaja. Është e vështirë për të provuar të vërtetën e këtyre deklaratave, por duket se, këto lëvizje nuk mund të zhvillohen me burimet e kufizuara brenda vendit.”<sup>17</sup> Raporti shtonte se: “duke kujtuar destabilitetin dhe pasigurinë që ka mbizotëruar vazhdimisht në vend, që nga njohja e tij nga Fuqitë e Mëdha, nuk është e papritur që ato janë përpjekur të avancojnë në interesat e tyre dhe të kundërshtojnë me çdo mjet të mundshëm ato të kundërshtarëve të tyre. Është gjithashtu e qartë se, influencat e huaja do të kenë tendencën të zvogëlohen kur kushtet në Shqipëri do të bëhen më të qëndrueshme.”<sup>18</sup> Pak kohë më vonë, i njëjti Komision, vinte në dukje se, ndërhyrja italiane kishte qenë evidente. Në raportin e tij thuhej: “Shkodra ishte e privuar nga të gjitha komunikimet me anë të tokës me Shqipërinë e jugut, përgjatë javës së dytë të marsit, për shkak të tentativës për revolucion nga italo-filët e pakënaqur nga qeveria e fundit, të cilët u financuan me fonde italiane”.<sup>19</sup> Ndërsa qeverinë e asaj kohe, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, e cilësonte italo-fobe por, jo serbofile. Edhe Komisioneri britanik në Komisionin e Kufijve kishte të njëjtin mendim dhe shkruante: “Në raportin e mëparshëm sugjerova që qeveria aktuale shqiptare, duke qenë se ishte tërësisht Italo-fobe, shprehte vetëm aspirata nacionaliste, përsëri nuk dyshohej se ishte serbofile, rrjedha e ngjarjeve të fundit e konfirmon një gjë të tillë.”<sup>20</sup>

Gjithashtu, edhe Eyres kishte dyshime të forta, ndonëse të pavërtetuara, për ndërhyrjen e qeverisë italiane në këtë konflikt, prandaj,

<sup>16</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 288; T. Selenica, *Shqipëria më 1927...*, f. 95-96.

<sup>17</sup> FO 371/7329, f. 285-293, Raporti i përgjithshëm i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, 12 prill 1922.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> FO 371/7330, f. 689-696, Ngjarjet nga 1 mars-31 mars 1922, Raport i Komisionerit britanik Hiles në Komisionin e Kufijve Serbo-Shqiptare, mbi tentativën për grusht shteti në Shqipëri.

<sup>20</sup> FO 371/7330, f. 720-732, Ngjarjet nga 1-31 maj 1922, Raport i Komisionerit britanik Hiles në Komisionin e Kufijve Serbo-Shqiptare, mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare, Shkodër, 31 maj 1922.

në mënyrë konfidenciale, ai i shkruante shefit të tij: “Ju kam dhënë deri tani aspektin sipërfaqësor të çështjes, por çështja interesante se të kujt ishin lëvizjet e para, është për t’u zgjidhur. Qeveria dhe njerëzit e ndryshëm në rrugë janë vendosmërisht të bindur se Italia është shtytësja dhe mbështetësja e komplotit. Ato pranojnë se nuk kanë prova dokumentare për t’i vënë këto akuza në letër, por thonë se Bajram Curri është mik i ngushtë i Italisë, Hasan Bej Prishtina, gjithashtu dhe se ato nuk kishin burimet e nevojshme për të organizuar një kryengritje kaq të zgjeruar. Mund të shtoj se, unë isha paralajmëruar, nga një burim informacioni, jo shumë larg nga Legata Italiane, që në një kohë të shkurtër, ngjarje të mëdha do të ndodhnin. Këto të dhëna, megjithatë, nuk janë prova të qarta përfundimtare, por ato shkojnë drejt justifikimit të një pjese të dyshimit. Personalisht, jam i prirur të besoj se, agjentët e Italisë në Shkodër ishin në dijeni dhe në simpati me komplotin, por dyshoj nëse kanë marrë pjesë aktivisht”.<sup>21</sup>

Karakterin antikushtetues të kryengritjes e pohon edhe Swire, i cili nuk i gjykonte shumë ashpër pjesëmarrësit e kësaj kryengritjeje. Swire shkruan: “Në marsin e vitit 1922, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Elez Isufi, etj., synuan ta rrëzojnë me forcë qeverinë e Tiranës, por forcat kryengritëse të Bajram Currit s’arritën dot deri në Shkodër ku e kishin objektivin. Aso kohe shtypi evropian shkruante se, gjatë “marshimit të tij Bajram Curri e kuptoi se opinioni publik ish i tëri kundër rrugës jokushtetuese që ai po ndiqte dhe si patriot i vërtetë që ish, u tërhoq pa shkaktuar gjakderdhje”. “Elez Isufi, një luftëtar i vjetër, trim por analfabet i irrituar nga vuajtjet e popullit të vet nën pushtimin sllav, arriti me trupat e tij deri në dyert e Tiranës. Qeveria i shpërndau në mënyrë të pamatur trupat që kishte në dispozicion të vet dhe dërgoi kolona të veçanta kundër tri forcave kryengritëse”.<sup>22</sup>

Ashtu si Vllamasi edhe studiuesi Bajram Xhafa ka pohuar se, lëvizja e opozitës për zgjedhje të reja për Asamblenë Kushtetuese, menjëherë pas dështimit të grushtit të shtetit, nuk nisej nga motive parimore të përcaktimit të formës së regjimit dhe të konsolidimit të shtetit, por nisej vetëm nga shpresa se me anë të zgjedhjeve të reja do t’ia arrinin qëllimit për marrjen e pushtetit. Më tej, ai thekson se, në të njëjtën kohë, opozita

<sup>21</sup> FO 371/733, f. 427-429, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, Durrës, 16 mars 1922.

<sup>22</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 213.

kishte mbledhur forca civile për të kundërshtuar forcat qeveritare. Në këto kushte, qeveria ishte e detyruar të bënte çarmatimin e popullsisë në të gjithë vendin. B. Xhafa, krejt ndryshe nga disa historianë të tjerë, shkruan se pas dështimit për ta marrë pushtetin me grusht shteti, disa nga krerët e opozitës nuk hoqën dorë për t'ia arritur qëllimit duke përdorur metodat ekstreme të dhunës, rebelimin e armatosur. Ata shkuan nëpër malësi për të siguruar bashkëpunimin me Bajram Currin, Elez Isufin e Halit Lleshin, të cilët zotëronin forca të konsiderueshme. Kështu filloi lëvizja për përmbyshjen e qeverisë. Me lëvizjen për përmbyshjen e qeverisë së Xhaferr Ypit u bashkuan edhe krerët e Kosovës si: Bajram Curri e Hasan Prishtina. Me lëvizjen u përfshinë edhe kundërshtarët politikë të Zogut si Hamit Bej Toptani etj., që njiheshin si esadistë dhe elementë që kishin pasuar politikën antishqiptare të Italisë si Mustafa Kruja. Ky bashkim forcash politike heterogjene, shumë kontradiktore u arrit si rezultat i veprimtarisë së Mustafa Krujës.<sup>23</sup>

Kryengritja antiqeveritare e marsit 1922, ishte e drejtuar kundër një qeverie legjitime që mbështetej nga një shumicë e dukshme në Parlament. Ajo ishte e motivuar, më së shumti, nga ambicia e shfrenuar vetjake e disa krerëve për të marrë pushtetin përmes dhunës dhe nga agjentë të vendeve fqinje, që synonin destabilizimin e vendit. Thirrjet për Asamblenë Kushtetuese, vetëm një vit pas zgjedhjeve dhe vetëm pak javë pas dështimit të grushtit të shtetit, ishin një pretekst politik për ta çuar vendin në zgjedhje të reja të parakohshme, në këtë situatë të turbullt e të pastabilizuar politike, kur ende Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve nuk kishte përfunduar caktimin e kufijve dhe akoma nuk ishte kryer regjistrimi i popullsisë. Asambleja që do të thirrej me grykën e pushkës, kurrsesi nuk mund të shërbente për të vendosur themelet e shtetit të ri shqiptar.

Argumenti se B. Curri dhe opozita po luftonin kundër tendencave autoritariste të Zogut është i dobët, pasi Zogu në këtë kohë ishte ministër i një qeverie të votuar nga një shumicë parlamentare dhe së paku nuk mund të akuzohej për veprime antiligjore. Megjithatë, duhet theksuar se, pas shtypjes së grushtit të shtetit të vitit 1921 dhe më tej pas shtypjes së kryengritjes së marsit 1922, pozitat dhe pushteti i Zogut ishin forcuar dukshëm dhe influenza e madhe e tij në qeveri dhe stili i tij mund të perceptoheshin deri diku si tendenca autoritariste. Në këtë drejtim, një

---

<sup>23</sup> Bajram Xhafa, *Historia e Shqipërisë 1912-1939*, Shkodër: Rozafat, 2006, f. 248.

kontribut kryesor kishin dhënë vetë veprimet e gabuara dhe antiligjore të opozitës. Gjithashtu A. Puto paraqet si një forcë demokratike, legale e antiautoritariste, bërthamën e “Bashkimit të Shenjtë”<sup>24</sup>, e cila kishte qenë njëkohësisht shkatërruese e këtij bashkimi dhe ndër organizatorët e grushtit të shtetit si dhe e kryengritjes së armatosur të marsit 1922, kundër rendit ligjor.

Në situatën e krijuar, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve tërhiqte vëmendjen se, vendi mund të shkonte drejt një diktature. Ndër të tjera, ai informonte: “Parlamenti nuk do të mblidhet deri në vjeshtën e ardhshme. Nga kjo rrjedh fakti se, qeveria ka marrë praktikisht përmasat e një fuqie diktatoriale.” Por, çuditërisht ai nuk e konsideronte këtë ndonjë fenomen shumë negativ. Në raport thuhej: “Qeveria tashmë ka tendencën t’ia kushtojë përpjekjet e saj krijimit të paqes dhe reformave. Çarmatimi i popullsisë duhet kryer, sistemi edukativ duhet forcuar, monogamia duhet forcuar me një ligj të ri, sistemi ligjor turk duhet të zëvendësohet nga një sistem ligjesh më modern dhe burimet ekonomike të vendit duhet të zhvillohen”.<sup>25</sup> Të gjitha këto detyra jetike për shtetin e ri shqiptar mund t’i kryente vetëm një qeveri e fortë.

Prandaj me të drejtë S. Vllamasi shkruan: “periudha që vazhdoi mbas dorëheqjes së Kabinetit të Sulejman Delvinës, deri në likuidimin e plotë të kryengritjeve Curr-Llesh-Elez-Hamit, ka qenë një periudhë që ka kaluar me grushte shteti dhe kryengritje, në të cilën në përfundim të përleshjes së tyre për vdekje, pala e rendit e arsyes dhe e tolerancës fitoi plotësisht ndaj palës së anarkisë, të pasioneve, të fanatizmës dhe të veglave të të huajve”.<sup>26</sup>

Pak a shumë këtë pikëpamje kishte edhe ministri britanik Eyres. Ai besonte tek triumfi të paktën i përkohshëm, i rendit dhe arsyes, por ndryshe nga Vllamasi, ai theksonte se, rreziqet ishin të mëdha dhe njëri prej tyre, pra, ai më i afërti, ishte mënyra se si qeveria do t’i trajtonte kundërshtarët politikë që kishin marrë pjesë në kryengritje. Ai shkruante: “Qeveria e ndjen se e ka rritur dukshëm prestigjin e saj në vend, për shkak të rezistencës së suksesshme ndaj forcave përçarëse dhe në qoftë se liderët e përmendur janë kapur, mund të thuhet se ka një mundësi për qeverinë konstitucionale të përparojë. Por në kundërshtim me këtë, sjellja

<sup>24</sup> A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 324.

<sup>25</sup> FO 371/7329, f. 380-382, Raport plotësues i Komisionit të Hetimit në Shqipëri, 13 maj 1922.

<sup>26</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 280.

e vrazhdë ndaj komplotistëve, mund të jetë një pengesë. Ky kontroll nuk mund të shpresohet se do të sjellë paqen në vend për një kohë të gjatë.”<sup>27</sup>

Një detaj tjetër interesant është fakti se, pas shtypjes së kryengritjes antiqeveritare të marsit, Eyres kishte ndryshuar mendim dukshëm dhe në sens pozitiv për veprimtarinë politike të A. Zogut. Ai më parë mendonte se Zogu po vepronte mbi bazën e interesave të tij personale. Për herë të parë ai pohonte se i kishte lindur një shkëndijë shprese se vendi mund të ecte drejt një stabiliteti relativ. Ai e njoftonte Londrën se: “Nuk ka dyshim se Ahmet Zogu, Ministri i Punëve të Brendshme, ishte heroi i krizës. Pa të, qeveria do të kishte degraduar. Jam habitur me energjinë dhe kapacitetin e tij dhe tashmë ndihem më me shpresë për të ardhmen, që prej *coup d’etat* të Aqif Pashës”.<sup>28</sup>

Kabineti Ypi, në funksion të programit për konsolidimin e shtetit, deklaroi më 3 maj 1922, se do të organizonte zgjedhjet për Asambleenë Kushtetuese, sapo të merrte fund regjistrimi i popullsisë dhe sapo të përfundonte caktimi i kufijve nga komisionet ndërkombëtare.<sup>29</sup> Tashmë debati politik u rikthye në Parlament. Opozita, e cila e kishte përkrahur direkt apo tërthorazi kryengritjen e marsit, ishte shumë e ashpër në ligjërimin e saj politik.

Nga fundi i tetorit 1922, qeveria i qëndroi me sukses një sulmi në parlament të opozitës së liberalëve demokratë, karakteristikë kryesore e të cilëve ishte padurimi, të cilët u mbështetën nga irredentistët. Të parët e kishin forcën e tyre tek “Vatra” e cila mbështetej nga shqiptarët ortodoksë të Shqipërisë Jugore, të cilët ishin të paduruar për reformën agrare dhe për reforma të tjera, ndërsa të fundit gjenin përkrahje në rajonet verilindore, që kishin vuajtur nga shkatërrimet e jugosllavëve dhe ishin në kontakt me bashkatdhetarët e tyre të shtypur në Kosovë. Të dy këto grupe donin një regjim më liberal dhe ishin kundër qëndrimit në pushtet të elementit konservator, që përbëhej kryesisht nga pronarë tokash dhe ish-zyrtarë në shërbim të Perandorisë Osmane. Këta edhe pse kishin më shumë përvojë se demokratët në artin e administrimit, ishin të prirë të pranonin rregullimin e vjetër turk të gjërave. Me të drejtë, studiuesi britanik Swire shkruante, “demokratët ushtronin trysni për reforma të menjëhershme dhe drastike, të cilat në një stad aq të hershëm të

---

<sup>27</sup> FO 371/7331, f. 441-442, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, 29 mars 1922.

<sup>28</sup> *Po aty*.

<sup>29</sup> T. Selenica, *Shqipëria më 1927 ...*, f. 101.

zhvillimit të vendit, do t'i kundërviheshin punës për konsolidimin e tij. Sigurisht shumica e reformave për të cilat ushtronin trysni demokratët ishte jashtëzakonisht e dëshirueshme dhe tashmë qe përfshirë në programin e qeverisë, por kjo e fundit vlerësonte se hapat e nxituar nga ligjvënës pa përvojë sillnin shkatërrim”.<sup>30</sup>

Nga ana tjetër, kjo betejë e egër për pushtet që u demonstrua në grushtin e shtetit dhe kryengritjen e marsit 1922, solli edhe shpërbërjen e “Partisë Progressive”, e cila deri në këtë kohë kishte pozitën e një partie opozitare. Gjithashtu, ndodhën edhe ndryshime në “Partinë Popullore”. Pas këtyre ndryshimeve në dy partitë kryesore, sistemi politik në Shqipëri pësoi një riorganizim të plotë. Në atmosferën e një lufte politike të ashpër në Parlament të krijuar pas grushtit të shtetit dhe kryengritjes së marsit dhe për shkak të kontradiktave brenda partisë, disa deputetë u larguan nga “Partia Popullore”, si Noli dhe disa përkrahës të tij, të cilët u bashkuan me opozitën. Kështu, dy ish drejtuesit e “Partisë Popullore”, Ahmet Zogu dhe Fan Noli, vetëm pas dy vjetësh bashkëpunim, tashmë ishin në krye të dy kampeve rivale.

Zogu mbeti në krye të “Partisë Popullore”. Kjo forcë politike tashmë e drejtuar prej tij, në median e shkruar dhe në fjalimet e opozitës, cilësohet më shumë si “Partia Qeveritare” ose shoqëria konservatore “Klika”. Është quajtur kështu, për arsye se, thelbi i kësaj partie ishte grupimi “Krahu Kombëtar”, i cili etiketohej nga kundërshtarët politikë me emrin “Klika”. Në fakt kështu ishte etiketuar edhe më parë nga kundërshtarët, veçanërisht nga përkrahësit e ish qeverisë së Durrësit. “Partia Përparimtare” u shpërnda. Qeveria në këtë kohë mbështetej nga “Partia Popullore” e nga disa deputetë të pavarur dhe kishte një shumicë të dukshme në Parlament. Tani forcat politike në Parlament ishin: “Partia Popullore” e reformuar dhe Opozita, e cila nuk ishte një parti apo grup i vetëm por, një tërësi grupesh politike. Pra, opozitarët shqiptarë nuk arritën të formonin një parti të vërtetë parlamentare të tipit perëndimor.

A. Puto, e ka vlerësuar pjesëmarrjen e Nolit në qeverinë “reaksionare” të Xh. Ypit, si një shkarje dhe largimin prej saj, si një ndreqje të këtij gabimi. Ky gjykim duket se nisët nga premisa ideologjike. Në të kundërt, mendojmë se po ta shohim çështjen në këndvështrimin e interesave të stabilizimit të shtetit shqiptar, të forcimit të qeverisjes dhe të institucioneve, largimi i Nolit ishte më tepër i dëmshëm në këto

<sup>30</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 319-320.

momente. S. Vllamasi, me të drejtë, ka quajtur si një veprim të gabuar jo pjesëmarrjen e Nolit në këtë qeveri, por largimin e tij prej saj dhe nga “Partia Popullore”. Noli u largua nga “Partia Popullore” bashkë me dy kolegët e tij vatanë, Kristo Kirkën dhe Loni Kriston, pa e justifikuar largimin e tyre. Në fakt, siç shpjegon Vllamasi, deri në këtë kohë nuk kishte ekzistuar ndonjë konflikt pikëpamjesh e parimesh midis këtij grupi dhe shumicës së partisë. Largimi ishte i papritur dhe i pashpjegueshëm. Duket se shkaku kryesor ishte armiqësia e Nolit me Sotir Pecin dhe pakënaqësia e tij për mbështetjen e pakufizuar, që kishte Peci në “Partinë Popullore”.<sup>31</sup> Kristo Kirka dhe Loni Kristo ishin të pakënaqur nga pozita që kishin në “Partinë Popullore”.

Edhe studiuesi Bernd Fischer thekson se: “pavarësisht prej famës së merituar në Lidhjen e Kombeve, Noli si ministër i Jashtëm ishte disi zhgënjyes dhe fakti që ai i dërgoi qeverisë së Tiranës dorëheqjen e tij nga Roma, sigurisht ishte një veprim që nuk ia shtonte meritat atij”.<sup>32</sup> Largimi i Nolit dhe demokratëve të tjerë pas tij, dobësoi “Partinë Popullore” dhe deri diku edhe stabilitetin e qeverisë. Por më tepër se kaq, ai dobësoi krahun liberal dhe reformator të kësaj partie dhe të qeverisjes, i cili ishte një element i domosdoshëm dhe shumë i vlefshëm ekuilibri brenda saj. Nga ana tjetër, ai do të forconte opozitën dhe do t’i shtonte asaj një segment të spikatur liberal, që i kishte munguar më parë.

Pak kohë pas largimit të këtij grupi edhe deputetët e Gjirokastrës S. Delvina, S. Vinjau, B. Omari, A. Këlcyra, R. Babameto dhe Agathli Xhitoni kaluan në opozitë. Ata e argumentuan largimin e tyre me mospëlqimin e Zogut si ministër i Brendshëm, për arsye të pozitive të forta, që kishte ai në qeveri. Ky argument ishte jo shumë bindës pasi, siç nënvizojnë Eyres, Selenica, S. Vllamasi etj., deri në këtë kohë Zogu nuk kishte ndonjë fuqi shumë të madhe pasi ushtria dhe xhandarmëria ishin në duart e anëtarëve të tjerë të “Partisë Popullore”. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, “që nga Kongresi i Lushnjës deri në shtypjen e kryengritjeve të fundit, Zogu i kishte bërë shërbime të mëdha vendit, duke i zbatuar në mënyrë të përpiktë vendimet e partisë së tij dhe ligjet e vendit. Ai kishte rezultuar tepër i nevojshëm për një parti që kishte marrë përsipër përgjegjësinë e stabilizimit të shtetit”.<sup>33</sup> Edhe Eyres, pasi e cilësonte

<sup>31</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 293.

<sup>32</sup> B. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet...*, f. 49.

<sup>33</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike ...*, f. 284.

Zogun si heroin e krizës, pohonte se, “paqes në Adriatik do t’i shërbehej më mirë duke e ndihmuar këtë udhëheqës të shquar shqiptar të qëndronte në fuqi”.<sup>34</sup> Largimi i këtyre deputetëve nga “Partia Popullore” lidhej më shumë me ambiciet e tyre individuale. Ata, nga ana tjetër, nuk ishin homogjenë në pikëpamjet e tyre, vetëm donin të rrëzonin qeverinë dhe të formonin qeverinë e tyre duke besuar se ishin njerëz me kulturë të lartë. Një pjesë e tyre sapo kishin dalë nga bankat e universitetit dhe besonin se ishin më të aftë për të drejtuar shtetin.<sup>35</sup> Gjithsesi duhet pohuar se, këto largime dobësuan krahun liberal të “Partisë Popullore” dhe forcuan atë të opozitës.

Politikani opozitar i asaj kohe, A. Këlcyra ka pohuar se, me largimin e deputetëve të Gjirokastrës u shkatërrua si “Partia Popullore” ashtu edhe “Klika”. Në fakt këto nuk u shkatërruan por, u dobësuan. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, opozita pas goditjes së rëndë që kishte pësuar, si rezultat i implikimit në ngjarjet e dhjetorit 1921 dhe të marsit 1922, u përforcua me këto prurje të reja nga kampi kundërshtar. Tashmë filloi një luftë e ashpër nga opozita kundër qeverisë së Zogut. Këlcyra fajin e të gjitha trazirave të viteve 1921-1923, ia ngarkonte “Klikës”. “Të gjitha turbullimet e sipërshënuara e kishin origjinën te frika e patriotëve, në fillim atyre të Veriut e më pas edhe atyre të Jugut, se Shqipërisë po i përgatitej një diktaturë e përkrahur nga jashtë. Në fillim dyshimet i inspiroi *Klika*, si kolektivitet. Kur kjo u shkatërrua, me propagandën e opozitës në parlament, atëherë dyshimet u përqendruan mbi personin e Zogut”.<sup>36</sup> Gjithsesi, opozita ishte shumë e larmishme dhe e pa unifikuar. Brenda saj vepronin rryma të ndryshme politike dhe grupime interesash të ngushta lokaliste.

Në vjeshtën e vitit 1922, opozita filloi një fushatë të fuqishme duke i kërkuar qeverisë të ndërmernte një sërë reformash dhe duke këmbëngulur tek reforma agrare, e cila u cilësua si më e ngutshmja. Ajo kërkoi largimin e elementëve konservatorë, që zinin poste të larta në administratë. Qeveria i quajti reformat të nevojshme, por ende të parakohshme. Ajo bëri disa hapa në këtë drejtim. Me vendim të

<sup>34</sup> Jason Tomes, *King Zog of Albania, Europe's self-made muslim monarch*, New York University Press, USA: 2004, f. 52.

<sup>35</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 295.

<sup>36</sup> Ali Këlcyra, *Shkrime për historinë e Shqipërisë: kujtime politike, si dhe shkrime të tjera e letërkëmbimi*, Tiranë: Onufri, 2012, f. 87.

Parlamentit shqiptar u hoq titulli “bej”, u shpall i paligjshëm dëbimi i bujqve nga pronarët kur ata i përmbushnin detyrimet e tyre etj.<sup>37</sup>

Disa muaj pas kryengritjes së marsit 1922, diplomati britanik Robert Parr, i dërgoi një raport interesant, Sekretarit të Jashtëm, Earl Balfour, mbi veprimtarinë e qeverisë së Xh. Ypit. Në radhë të parë, ai vlerësonte përpjekjet e “Partisë Popullore” për të ndërtuar një qeveri të qëndrueshme dhe pranonte se kjo e fundit, ia kishte arritur deri diku qëllimit. Në lidhje me këtë çështje, Parr shkruante: “Gjatë këtij viti qeveria ka qenë e shqetësuar për të hedhur bazat e një qeverisjeje të stabilizuar. Fakti kryesor, është që qeveria ka qenë e kërcënuar nga forca të brendshme dhe të jashtme dhe këto punë nuk mund të vazhdojnë pa shkaktuar rrezik për pavarësinë e vendit. Faktikisht, çdo ministri, me përjashtim të dy prej tyre, kanë rënë nën këtë kërcënim. Partia kryesore në Parlament, deputetët e jugut në përgjithësi dhe disa nga deputetët e veriut, ishin të lodhur nga shqetësimet e vazhdueshme dhe kërkonin krijimin e një qeverie të fortë, të aftë për t’u marrë me këtë çështje”.<sup>38</sup> Si forca destabilizuese në vend, Parr veçonte “shumicën e pashallarëve dhe të bejlerëve, të cilët nuk mund të duronin pakësimin e fuqive dhe privilegjeve; malësorët e veriut, të cilëve nuk u pëlqente ideja e humbjes së gjysmë-independencës së tyre dhe mirditorët, që ishin mashtruar nga udhëheqësit tradicionalë”.<sup>39</sup>

Gjithashtu, Parr relatonte se, pas ngjarjeve të grushtit të shtetit, zgjedhja e “Partisë Popullore” kishte rënë mbi Ahmet Zogun, i cili u veçua si i vetmi person që mund të merrej me situatën e brendshme. Kështu drejtuesit e partive, të mbledhur në Elbasan, e emëruan atë Ministër të Punëve të Brendshme dhe Xhafer Ypin, President të Këshillit. Këtu Parr pohonte qartazi se, Zogu ishte zgjedhur si personi më i përshtatshëm që mund të stabilizonte qeverisjen në këtë periudhë, duke kundërshtuar në këtë mënyrë historiografinë shqiptare të mëparshme, e cila e ka parë emërimin e Zogut, rezultat të ambicies së tij për pushtet.

Në analizën e detajuar që diplomati britanik i bënte anëtarëve të qeverisë së Ypit, shkruante: “*Më vjen keq të them se Xhafer Ypi, nuk ka treguar asnjë nga ato cilësi, të cilat kërkohen për pozicionin e tij. Më duket shumë i limituar në inteligjencë, shumë i dyshimtë dhe me karakter*

<sup>37</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 325-326.

<sup>38</sup> FO 371/7330, f. 628-630, Telegram i Robert Parr për Earl of Balfour, mbi qeverinë e Xhafer Ypit, Durrës, 30 korrik 1922.

<sup>39</sup> *Po aty*.

*të keq. Nuk e mban kabinetin të bashkuar, nuk e ka idenë se çfarë bëhet nëpër ministri dhe nuk jep shembullin e tij të punës energjike. Personalisht, e kam parë të sjellshëm dhe të këndshëm, duke qenë gjithmonë i gatshëm për të dëgjuar këshilla dhe për të vepruar mbi to”.*

*“Ahmet Zogu, për pasojë është bërë dhe për shkak të aftësisë së forcës së karakterit, personazhi më i rëndësishëm në kabinet. Ai e pranon hapur injorancën e tij në punët e jashtme dhe ia ngarkonte atë kolegëve të tij, megjithëse insiston të konsultohet me to, përpara çdo hapi të rëndësishëm. Ai përfshin në personin e vet, të gjithë forcën qeverisëse të kabinetit. Është shumë punëtor dhe shumë energjik. E kaluara e tij nuk është “aksident”, duke bërë disa veprime të dyshimta ndershmërie, që shkaktuan tmerrin e patriotëve shqiptarë për ardhjen e tij në pushtet. Por ai ishte dhe është akoma, shumë i ri, dhe ndërsa unë isha një nga ata që besoja se ambicia e tij personale ishte motivi kryesor për pushtetin e tij, tashmë kam ndryshuar mendim dhe me gëzim njoh se ka treguar cilësi të shkëlqyera të mendjes dhe zemrës, në administrimin e vendit. Kurajo e tij në marrjen e vendimit dhe kryerjen e çarmatimit të popullsisë së veriut ishte për t’u admiruar dhe kjo ngjarje ka justifikuar vetëbesimin e tij. Nëse, në këto momente, qeverisë i binden të gjitha krahinat e Shqipërisë, siç nuk iu kanë bindur asnjë qeverie tjetër për 500 vjet, është tërësisht për shkak të tij, dhe metodat e tij, të marra në kompleks nuk kanë qenë shumë të ashpra. Ai i ka drejtuar përpjekjet e tij kundrejt ekonomisë, administrimit të mirë, drejtësisë së pavarur dhe përmirësimit të shërbimeve publike”. Duke vazhduar më tej në analizën e tij për figurën e A. Zogut, Parr shkruante: “Është e vërtetë që ai nuk mund të bëjë gjithçka, por gjithçka që është bërë është realizuar prej tij. Ai ka, siç është e natyrshme, shumë armiq, por shumica e njerëzve që kanë sulmuar atë ose qeverinë ku ai ka qenë anëtar, janë në mërgim. Nuk kam dëshirë të sugjeroj, se ai nuk ka asnjë të metë dhe nuk bën asnjë gabim, ai ka bërë shumë të tilla, por duke marrë në konsideratë edukimin e tij dhe mundësitë që ka pasur, ai ka vepruar jashtëzakonisht mirë dhe meriton mirënjohjen e vendit të tij”.*

Më tej diplomati britanik, analizonte edhe anëtarët e tjerë të qeverisë, për të cilët shkruante: *“Ministri i Financave, Kol Thaçi, është një njeri i ndershëm dhe ortodoks nga jugu. Por për aq sa kam dijeni, ka përfituar pak ose aspak në linjën e tij të veçantë. Ai duket se është inekzistent, ashtu si Ministri i Drejtësisë, Hysen Bej Vrioni.*

*Ministri i Edukimit, Rexhep Bej Mitrovica, është një njeri me karakter dhe energjik. Ai ka punuar shumë për problemet e shkollës dhe të edukimit dhe ndërsa puna vazhdon, ndoshta është njeriu i dytë më i mirë në kabinet. Ministri i Luftës, është një ushtar i pastër dhe i thjeshtë dhe është mjaft efektiv në sferën e tij. Por është pothuajse injorant mbi çështjet e tjera dhe nuk i shton asgjë urtësisë së kabinetit. Z. Spiro Koleka, Ministri i Punëve Publike, me shumë mundësi është më i dobëti nga të gjithë. Ai nuk sjell asnjë efekt dhe administrata e tij është e mbushur me nëpunës të paaftë. Ahmet Zogu, që veproi si Ministër i Punëve Publike, gjatë mungesës së tij, arriti të menaxhojë departamentet, të cilat ishin një letër e vdekur, në kryerjen e një aktiviteti të konsiderueshëm.*

*Lista nuk do të ishte e plotë pa iu referuar Peshkop Fan Nolit, i cili në fillim të qeverisjes, pranoi portofolin e Punëve të Jashtme. Ai kishte fituar një reputacion të madh në Konferencën e Lidhjes së Kombeve, në Gjenevë dhe e meritonte një gjë të tillë. Prandaj ishte disi zhgënjim të zbuloje se nuk ishte veçanërisht efektiv në postin e tij të ri, sidomos në letër. Megjithatë, ai ishte padyshim një asset me vlerë të konsiderueshme për qeverinë dhe ishte një shok i madh, kur gjatë rrugës për në Gjenevë, ku do të merrte pjesë në Konferencë, ai papritur dërgoi dorëheqjen e tij nga Roma. Veprimi i tij është akoma i pashpjegueshëm dhe shpjegimet e mundshme nuk i japin atij një vlerësim pozitiv”. Në përfundim, Parr konkludonte: “Mund të shtoj se, elementi i krishterë në Shqipëri, ka qenë, nga pikëpamja administrative, një dështim i vërtetë, kudo që është përprjekur, dhe kjo përsëri, ndonëse e papritur, është një pengesë serioze për një vend i cili, mbi të gjitha, kërkonte njerëz me aftësi administrative”.<sup>40</sup>*

Kjo analizë e Parr na ndihmon të nxjerrim disa përfundime. Së pari, këtu evidentohet paaftësia qeverisëse e Xh. Ypit, e cila, sigurisht, ndikoi në rritjen e peshës së Zogut në qeveri, ndonëse, ky nuk ka qenë faktori i vetëm; së dyti, Parr tashmë kishte ndryshuar rrënjësisht mendimin mbi personalitetin e Zogut, duke përmbysur mendimet e mëparshme dhe duke evidentuar se, ai kishte vepruar në mënyrën më të mirë të mundshme për qeverisjen e vendit. Me këtë raportim, ai hidhte poshtë gjykimin e vet të mëparshëm dhe të kolegut të tij Smith, se Zogu po vepronte me metoda të kritikueshme, i udhëhequr vetëm nga ambicia e tij personale; së treti, bie

<sup>40</sup> Po aty.

në sy vlerësimi kritik i dorëheqjes së Nolit, për të cilën jemi të njëjtit mendim dhe që është në kundërshtim me vlerësimet që ka bërë historiografia e mëparshme apo edhe autorë të sotëm.

Zhvillimet politike të fundit të vitit 1921 dhe ato të vitit 1922, vunë në provë të gjitha institucionet politike shtetërore të krijuara nga Kongresi i Lushnjës. Rënia e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë, shënoi pikën më kritike të këtij organi të lartë kushtetues dhe indirekt, edhe dështimin e formulës qeverisëse të përzgjedhur në Kongresin e Lushnjës. Më tej, autoriteti dhe pesha e këtij institucioni të lartë do të pësonte një rënie të ndjeshme, ndërsa dominimi i Parlamentit mbi të, do të rritej. Pjesëmarrja e Këshillit të Lartë në grushtin e shtetit dhe pasojat që rrodhën prej saj do të acaronte në kulm edhe marrëdhëniet midis grupeve politike në gjirin e Parlamentit dhe jashtë tij. Në këtë mënyrë, institucioni i kryetarit të Shtetit, në vend që të ruante unitetin dhe kohezionin politik në vend, çka është prerogativë kryesore e tij, do të kthehej në një mekanizëm konfrontimi dhe përçarje politike të thellë dhe me pasoja të pariparueshme.

Parlamenti në mbledhjen e parë, në dhjetor të vitit 1921, diskutoi mbi deputetët e Drinit dhe, duke marrë parasysh se në viset e kësaj prefekturë, që u liruan nga okupacioni jugosllav nuk ishin bërë zgjedhjet parlamentare të rregullta dhe mbasi populli i asaj prefekturë kërkonte të bëheshin zgjedhje të lira, vendosi t'i rrëzojë ata nga deputetësia. Sigurisht në këtë qëndrim, ndikoi shumë angazhimi i tyre në mbështetje të grushtit të shtetit. Largimi i deputetëve që kishin marrë pjesë në komplot, do ta nxirrte ballafaqimin politik nga brenda Parlamentit, jashtë tij dhe do ta kthente atë nga një ballafaqim politik brenda suazës konstitucionale, në një konflikt jashtë saj dhe që do të merrte trajtën e një konfrontimi me armë, për shkak se krerët e larguar nga parlamenti, dispononin forca paramilitare të gatshme për t'u vënë nën urdhrat dhe komandën e tyre. Pra, Këshilli i Lartë u bë shkak edhe për krizën e Parlamentit dhe parlamentarizmit në Shqipëri në këtë periudhë.

Por, edhe vetë kriza e këtij institucioni nuk do të mbaronte këtu. Ajo u shfaq sërisht me forcë gjatë kryengritjes së marsit 1922, kur dy regjentët Ndoc Pistulli dhe Ymer Pashë Vrioni, krejt papritur dhanë dorëheqjen. Për të kuptuar situatën e krijuar, mjafton të japim diskutimet që u bënë në atë kohë në Parlament, të cilat ishin tepër të tensionuara. Në diskutimin e tij Koço Tasi theksonte: "Dorëheqja e dy pjesëtarëve të Këshillit të Naltë u bë në një kohë, që edhe sikur vdekja tu kishte ardh, lipsesh të qëndronin në detyrë, e mos ta kishin ba një punë të tillë. Përmbi interesat e partisë

lypet të qëndrojë e drejta. Këta Zotëni dhanë dorëheqjen në një kohë shumë kritike për Shtetin tonë. Po sikur të kishin dhanë dorëheqjen edhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Naltë si edhe Ministrat, nuk e di ku do të kishte vajtur gjendja e Atdheut tonë.” Pas tij, deputeti N. Ivanaj u shpreh: “Për arsye se dy anëtarët e Këshillit të Naltë dhanë dorëheqjen e tyne natën e kryengritjes janë të dënuem moralisht se dorëheqja e tyne mundet me qenë e lidhun me kryengritjen, jo pse kishin pjesë në kryengritje, por pse ata zotëni e dhanë dorëheqjen, pse e dinin se do të plaste kryengritja”.<sup>41</sup> Deputeti H. Mosi shtonte se, Parlamenti kishte emëruar Omer Pashë Vrionin e Ndoc Pistullin, sepse tek ta “na të gjithë kishim një shpresë të plotë, mbasi ishim të bindun në atdhetarinë e tyne. Mjerisht u disiluzionuem sepse prova ma e bukur për me dftue atdhetarinë e tyne ishte kur rebelët u ngritën dhe erdhën në Tiranë për me rrëzue një qeveri që kishte besimin e përfaqësuesve të popullit, Zotnitë e tyne dhanë dorëheqjen dhe mbanin nën presion automobilat e tyne, kur ushtarët baheshin therorë për me mprojtë Atdhen”.<sup>42</sup>

Zëvendësimi i anëtarëve të dorëhequr, u bë me vështirësi dhe provonte se plotësimi i këtij organi të lartë ekzekutiv, ishte një detyrë e vështirë. Problemet kryesore me të cilat u përballën ligjvënësit, dëshmohen në diskutimet që ata bënë në seancat parlamentare. Kështu, Mehdi Frashëri, këmbëngulte për zgjedhjen e personave me autoritet dhe të paanshëm, pra, jo partiak. Ai argumentonte: “Anëtarët e Këshillit të Naltë, zenë vendin e një presidenti të Republikës, të një mbreti ose me një fjalë tjetër përfaqësojnë fuqinë sovranë. Cilësia ma me randësi e një fuqie sovranë asht pa-anësija e plotë, sepse po t’i mungojë fuqisë sovranë pa-anësija e plotë, atëherë kjo, jo vetëm mbetet pa randësi, por bahet dhe e damshme. Kjo sepse ky Parlament përbëhet prej dy partive, prej një partie që asht sot në fuqi, e prej partisë së opozicionit. Në qoftë se anëtarët e Këshillit të Naltë do të zgjidhen nga partia e opozitës, qeveria do të ndodhet karshi ndalimeve nga ana fuqisë sovranë. Në qoftë se dalin nga partia e shumicës, atëherë çdo të bëjë kabineti, do të bëjë edhe Këshilli i Naltë e mjete moderator do të mungojë. Pra në këtë zgjedhje, duhet pikë së pari të kemi parasysh që të zgjidhen njerëz të paanshëm. Mbas paanësisë vinë cilësitë që duhen të kenë anëtarët e Këshillit të

<sup>41</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombtar (BKK)*, Viti II, 1922, f. 305-313. Diskutimet mbi dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit të Naltë, 3 tetor 1922.

<sup>42</sup> *Po aty*.

Naltë. Këto janë moraliteti, ditunija e sidomos karakteri, d.m.th. që të ketë një karakter të fortë që mos të bahen veglat e njerit apo tjetrit”.<sup>43</sup> Ky ishte një propozim dhe argumentim konstruktiv dhe tepër i dobishëm për kohën dhe momentin ku gjendej Shqipëria dhe ky institucion. Paanësia dhe respektimi rigoroz i ligjit nga Këshilli i Lartë, mund t’i kishte shërbyer mjaft stabilitetit dhe ruajtjes së ekuilibrave në shtetin e ri, i cili po kalonte fazën e foshnjërisë së tij, të shoqëruar me plot dhimbje e kriza. Por, klasa politike e asaj kohe, ishte shumë larg konceptimit dhe realizimit të një projekti të tillë për institucionin e lartë të kryetarit të shtetit.

Nga ana e tij, N. Ivanaj mbështeti propozimin e M. Frashërit, duke shtuar se, kur Këshilli i Lartë kishte katër anëtarë puna nuk kishte shkuar aq mirë ndërsa kur ai mbeti me dy anëtarë, “punët na kanë shkue pa ngatrra e pa dredhi.”<sup>44</sup> Ai propozoi, që të mos zgjidheshin dy anëtarët e tjerë, duke argumentuar se zgjedhja e tyre, do të shkaktonte një pakënaqësi të brendshme apo të jashtme, edhe ndoshta ndonjë krizë ministrore të parakohshme. Ky propozim ishte i papranueshëm, pasi cenonte formulën e përcaktuar nga Kongresi i Lushnjës dhe si pasojë nëse do të pranohej nga Parlamenti, do të bëhej shkak për kriza dhe shkelje të tjera. Prandaj edhe nuk u mbështet prej tij. Njëri nga krerët e opozitës së asaj kohe, Ali Këlcyra, si shkak të trazirave në zgjedhjen e Këshillit të Lartë, konsideroi partinë e shumicës, sepse dy anëtarët e këtij institucioni kishin qenë të zgjedhur në parti por, më në fund nuk kishin rënë dakord. Ai kundërshtoi propozimin që Këshilli i Lartë të mbetej me dy anëtarë dhe kërkoi plotësimin e tij me katër anëtarë.

Në këtë konflikt të ashpër politik, u arrit deri aty sa të viheshin në pikëpyetje edhe vendimet e Kongresit të Lushnjës, i cili kishte vlerën e konstituimit të shtetit shqiptar dhe të bazave të tij. Interesante në këtë rast, ishte replika e N. Ivanajt, i cili pohonte se: “Kongresi i Lushnjës nuk ishte një kongres legjislativ për gjithëmotin e jetës, por qe një gja e përkohshme”. Ai vinte në dukje se, “ky kongres kishte një rëndësi të posaçme, sepse kishte shpëtuar Shqipërinë në një moment shumë kritik”, por, ai “nuk vuni ligja themeltare për gjithmonë, e se ç’ka ka caktue Kongresi i Lushnjës nuk do me thanë se nuk mund të ndryshohet asgjë

---

<sup>43</sup> *Po aty*, Viti II, 1922, f. 595- 603. Bisedime për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Naltë, 28 tetor 1922.

<sup>44</sup> *Po aty*.

pse Kongres i Lushnjës bani edhe asi sendesh qi s'duhesh të baheshin e se ra edhe në disa gabime të cilët na kanë kushtue shumë.”<sup>45</sup> Ky, ishte një gjykim kritik për veprimtarinë ligjvënëse të Kongresit, i cili, ka një vlerë të posaçme, për të kuptuar larminë e mendimit politik e juridik të asaj kohe. Gjithashtu, Ivanaj theksonte edhe faktin tjetër, se ky nuk ishte propozimi i parë, që devijonte nga vendimet e Kongresit të Lushnjës, por se “vendimet e Kongresit të Lushnjës nuk janë vënë pikë për pikë në veprim”. Në fund ai pohoi se, ky parlament kishte një autoritet dhe kompetencë më të lartë se Kongresi i Lushnjës. “Mos harroni, shtoi ai, se edhe na këtu jemi një soj asambleje e se Kongresi i Lushnjës nuk ishte një assamble, por ma tepër, një komitet për me pështuë atdheun prej rrezikut.”<sup>46</sup>

Tashmë në situatën e re vijuan përpjekjet për plotësimin e akteve kushtetuese të shtetit dhe demokratizimin e institucioneve. Akti më i rëndësishëm ishte zgjerimi i Statutit të Lushnjës, që ishte parashikuar nga vetë Kongresi i Lushnjës. Këshilli Kombëtar i dalë nga zgjedhjet e vitit 1921, kishte formuar më 1 gusht të atij viti një komision të posaçëm për plotësimin e Statutit të Lushnjës, në të cilin bënin pjesë politikanë të njohur të vendit dhe përfaqësues të shumtë të opozitës, njerëz të ditur dhe me kulturë, si: Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Hoxha Kadriu, Stavro Vinjau etj. Kjo përbërje ishte një shenjë e mirë dhe dëshmonte vullnetin e shumicës për të ndërtuar një sistem politik liberal, që të kishte konsensusin e opozitës.

Projekti i Statutit të Zgjeruar të Lushnjës i hartuar nga ky komision, iu paraqit Këshillit Kombëtar në dhjetor 1922 dhe po në këtë muaj u miratua prej tij. Miratimi i këtij Statuti shënonte një hap të rëndësishëm në konsolidimin dhe demokratizimin e shtetit shqiptar. Statuti ishte një ligj kushtetues i përkohshëm, që do të qëndronte në fuqi deri në miratimin e statutit përfundimtar të shtetit shqiptar nga Asambleja Kushtetuese. Nga historiografia e derisotme, me plot të drejtë është nënvizuar fakti themelor se, Statuti i Zgjeruar i Lushnjës ishte një ligj themeltar me karakter demokratik.<sup>47</sup> Por, jashtë vëmendjes ka mbetur karakteri praktik dhe zbatueshmëria e këtij ligji në rrethanat e Shqipërisë së atëhershme.

---

<sup>45</sup> *Po aty.*

<sup>46</sup> *Po aty.*

<sup>47</sup> “*Statuti i Shtetit Shqiptar*”, Tiranë: Nikaj 1922.

Një qëndrim kritik ka mbajtur në këtë drejtim politikani i asaj kohe S. Vllamasi, qëndrim i cili na duket i argumentuar. Duhet theksuar se, kujtimet e tij, për këtë çështje, përputhen edhe me pikëpamjet e diplomatëve britanikë, për problemet e ndërtimit dhe funksionimit të një sistemi demokratik në Shqipëri. Ky i fundit, ka mbajtur një qëndrim kritik ndaj formës së regjimit që sanksionoi Kongresi i Lushnjës, e cila pastaj u zhvillua dhe detajua më tej me miratimin nga Parlamenti shqiptar i Statutit të Zgjeruar të Lushnjës. Lidhur me këtë ai shkruante: “Shumica e deputetëve, nga dëshira e zjarrtë për ta parë popullin në një nivel të lartë, kujtoi se ky nivel mund të arrihej me shpejtësi, duke i dhënë një populli të pazhvilluar liritë më të gjëra të një shoqërie demokratike. Nga kjo situatë ju la fushë e lirë ambiciozëve dhe veglave të të huajve me qëllim që ta gabonin popullin dhe ta bënë vegël për qëllimet e tyre jo legjitime. Dhe me të vërtetë kështu u bë, Opozita, si në Parlament ashtu edhe në shtyp, bëri çmos, derisa lehtësoi shkatërrimin e gjendjes që kishte hyrë në rrugën e stabilizimit dhe në fund të vitit 1923, gjendja stabile përfundoi mbasi u shkatërrua shumica, që kishte qenë garancia më e fortë e të ardhmes, kurse shteti ra në duar të paafta të elementit me kulturë të lartë.”<sup>48</sup>

Ky opinion i Vllamasit, i cili deri më sot, nuk është vlerësuar në aspektin e përshtatshmërisë së formës së qeverisjes dhe institucioneve që i nevojiteshin dhe i shkonin për shtat gjendjes politike dhe shoqërore të Shqipërisë së asaj kohe, meriton të shihet me kujdes dhe rreth tij të reflektohet sa më thellë. Duke pohuar faktin real se, opozita shpërdoroi lirinë e gjerë që krijonte Statuti i Zgjeruar i Lushnjës dhe se kushtetuta e re, si institucion juridik, në kushtet e aktivitetit të një opozite që nuk i përgjigjej nivelit të saj, prodhoi në vend të demokratizimit, destabilizimin e shtetit dhe të institucioneve të tij, Vllamasi ka ngritur për diskutim një problem esencial që lidhet me përshtatshmërinë e formës së regjimit politik dhe të institucioneve politike të kësaj kohe.

Në fakt, opozita nuk bëri vetëm një aktivitet denigrues, siç thotë në mënyrë tendencioze Vllamasi por, ajo zhvilloi një veprimtari opozitare, e cila brenda Parlamentit ishte e vlefshme dhe la gjurmë pozitive në shumë drejtime. Pas zgjerimit të Statutit të Lushnjës, opozita dhe opozitarizmi, ashtu si dhe gjithë institucionet e tjera politike, u kodifikuan dhe u organizuan më mirë dhe kjo dha efekte pozitive, duke krijuar një përvojë

<sup>48</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 285-286.

në këtë rrugë tepër të vështirë për një shtet dhe një shoqëri si ajo shqiptare. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, vlerësimi i Vllamasit është i njëanshëm, pasi sistemi i ri politik me institucione demokratike nuk shfaq vështirësi dhe probleme vetëm për shkak të veprimeve të opozitës. Por, duhet theksuar se, edhe shumica qeverisëse nuk u përshtat si duhet me këtë sistem demokratik, duke shfaqur tendenca shformuese dhe kriza shpërbërëse brenda saj. Këto probleme u shfaqën para vitit 1922, gjatë dhe pas tij.

Studiuesi Robert Austin, ndonëse nuk është kaq kritik ndaj opozitës, pohon një element të kritikave të Vllamasit ndaj saj dhe pikërisht mungesën e një programi të përbashkët parimor dhe bashkimit e saj rreth një qëllimi të vetëm utilitar, rrëzimin e qeverisë dhe luftën personale kundër Zogut. Ai shkruan: “Argumenti më kryesor në bashkëpunimin ndërmjet grupeve të opozitës, ishte e mbeti deri më 1924, kundërshtimi i Ahmet Zogut e linjës politike të ndjekur prej tij. Zogu në këtë periudhë, ishte figura më e shquar e bllokut konservator, ai mbështetej nga deputetët e Shqipërisë së Jugut si: Eshref Frashëri e të tjerë, të cilët nga opozita dhe shtypi i saj, cilësoheshin me epitelin “Klikë“. Ndërsa mjaft deputetë nga Veriu, madje nga më të shquarit, si Luigj Gurakuqi, ishin në radhët e opozitës.”<sup>49</sup>

Duke komentuar jetën politike në Tiranën e atyre viteve Mit'hat Frashëri, penë e rëndësishme e kohës, jep këtë përshkrim për opozitën: “Deputetët ndahen më dysh: në ata që flasin dhe ata që heshtin: në të parën janë Ali Këlcyra, Stavro Vinjau, Luigj Gurakuqi, Koço Tasi, Fan Noli, Bahri Omari, të gjithë nga opozita me të cilët janë përshtjell gjithë oratorët, gjithë njerëzit që duan të bëhen secili një kryetar më vete, po që inati kundra qeverisë që është në fuqi i bën të bashkohen kundra saj, opozita ka trembëdhjetë mbase dhe katërbëdhjetë veta”.<sup>50</sup> Nga ky përcaktim interesant i M. Frashërit konfirmohen tre tipare të opozitës së asaj kohe. Së pari, ajo ishte aktive në parlament dhe demonstronte majën e nivelit intelektual dhe progresist të diskursit politik të asaj kohe; së dyti, ajo përbëhej nga individë të shquar, të cilët ndjeheshin të gjithë si krerë opozitarë pa pasur një organizim dhe hierarki institucionale midis tyre; dhe së treti, ata nuk kishin përpunuar program politik rreth të cilit të

<sup>49</sup> Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë: Albin, 2003, f. 97.

<sup>50</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 35, viti (më tej: V.) 1922, dosja (më tej: D.) 24, fl. 6.

bashkoheshin dhe të ndërtonin aksionin politik. I vetmi motiv përbashkues, thotë M. Frashëri, i cili nga ana e tij, ishte simpatizant i opozitës, ishte kundërshtimi i qeverisë dhe i A. Zogut, çka dëshmonte varfëri për një opozitë të mirëfilltë dhe moderne.

Vllamasi ka nënvizuar edhe mungesën e vullnetit të opozitës për të bashkëpunuar me shumicën qeverisëse në ato rrethana të vështira. Ai pohonte se: “Mospranimi i një pjese të opozitës për të bashkëpunuar me një shumicë, që në kushte jashtëzakonisht të vështira krijoi dhe stabilizoi shtetin mbi baza moderne, me dashje ose pa dashje, rezultoi një gabim i rëndë dhe me pasoja shkatërruese për atë kohë. Një pjesë e opozitës jo vetëm që nuk bashkëpunoi, por për konsiderata meskine, për hakmarrje e karrierë e luftoi shumicën deri në shkatërrim dhe u bë shkak që ta lërë shtetin në një situatë kaotike”.<sup>51</sup>

Ndonëse nuk duhet parë si një përcaktim përfundimtar dhe plotësisht real, është interesant se si i portretizon qëndrimet e opozitës Sejfi Vllamasi. Ai shkruante se, “një pjesë e opozitës, si Luigj Gurakuqi e tjerë, e bënë këtë luftë për të marrë hakën e Kongresit të Lushnjës dhe për ta zëvendësuar politikën e atij Kongresi me një politikë proitaliane. Pjesa e dytë e opozitës, e bënë luftën për të ardhur në fuqi e për t’u bërë ministra pa kontroll dhe në sajë të fuqisë shtetërore të krijonin pozita të privilegjuara, si Qazim Koculi e Ali Këlcyra. Pjesa e tretë, ishte ajo pjesë që nuk e kishin kuptuar mirë gjendjen e vendit, nuk i njihnin mirë personat që merreshin me politikë dhe qëllimet e tyre dhe kështu kanë rënë viktimë në jetën e tyre politike, si Shuk Gurakuqi, vegël e Luigj Gurakuqit dhe e Mustafa Krujës, Bahri Omari, Rasim Babameto, Dhimitër Kacimbro, Kristaq Kirka, Loni Kristo etj., të influencuar nga Faik Konica, Fan Noli dhe nga mosqënia të qartë në gjykimin e vërtetë të situatës”.<sup>52</sup> Por, këto pohime duhen marrë me rezervë, pasi brenda tyre, krahas vërtetësisë, ka doza subjektivizmi dhe teprimi për faktin se autori i tyre, edhe pse i ka shkruar kujtimet e veta dekada më vonë, ishte i përfshirë drejtpërdrejt në politikën e kohës dhe ishte një nga drejtuesit e “Partisë Popullore”. Nga ana tjetër, duhet theksuar se edhe qeveria nuk mbajti qëndrimet e duhura elastike dhe të moderuara që ishin jetike për këtë fazë kritike të jetës së vendit, ndonëse duhet nënvizuar fakti se, ajo

<sup>51</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 325.

<sup>52</sup> *Po aty*, f. 327-328.

zbatoi me korrektesë normat kushtetuese dhe ligjore që ishin në fuqi në atë kohë.

Sigurisht këto tendenca të rrezikshme, në radhët e opozitës, ekzistonin. Por këtu duhen shtuar edhe dy fakte themelore. E para, opozita nuk ishte vetëm rebele dhe shkatërruese, siç e kanë paraqitur autorët e lartpërmendur por, siç e theksuam edhe më sipër, ka dhënë edhe kontribute të çmuara për qeverisjen dhe parlamentarizmin në Shqipëri në vitet 1920-1924. Idetë dhe artikulumet e saj, ishin vlera dhe shpirti i Parlamentit dhe i rritjes së opinionit përparimtar në vend. Pra, vlerësimet ekstreme pozitive ose negative për të, mendojmë se janë jo të sakta dhe gjykojmë se vlerësimi objektiv për të duhet të ndjekë këtë rrugë të mesme. Kjo, veçanërisht kur bëhet fjalë për opozitën legale. Legaliteti, pra zhvillimi i veprimtarisë së saj në përputhje me ligjin e funksionimit të Parlamentit dhe parlamentarizmit, duhet të jetë vija ndarëse dhe optika e vlerësimit midis opozitës parlamentare dhe asaj të dhunshme. Edhe aktiviteti i qeverisë dhe i shumicës qeverisëse, duhet të gjykohet në raport me maturinë politike, efektivitetin qeverisës dhe mbi të gjitha me korrektësinë në zbatimin e ligjit. Për këtë arsye, pikëpamjet e shprehura nga Vllamasi, se opozita kontribuoi për shkatërrimin e kolektivitetit politik të partisë qeverisëse-“Partisë Popullore”, nuk janë të sakta, por janë tendencioze, pasi bëhen duke u nisur nga interesa të caktuara politike dhe jo nga kushtetutshmëria e ushtrimit të opozicionit.

Nga ana tjetër, tendencat që shkonin drejt krijimit të klimës jo të shëndoshë politike në vend, nuk ishin vetëm në radhët e opozitës por edhe të grupit qeverisës. Gjatë vitit 1922, vijuan ndarjet dhe konfliktet brenda qeverisë, të cilat e bënë “Partinë Popullore” më të brishtë dhe situatën brenda saj më konfliktuale. Kjo krizë në qeverisje e shtoi polarizimin politik dhe krijoi premisat për destabilitet, i cili nuk do të vononte. Pikërisht këto ishin rrethanat dhe arsyet, të cilat do ta shtynin Zogun që të merrte vetë në dorë kryesimin e qeverisë dhe shumicën e “Partisë Popullore” ta mbështeste këtë ndryshim politik. Pas një periudhe qetësie në vend, me një dekret të Këshillit të Lartë të Shtetit, më datë 2 dhjetor 1922, Ahmet Bej Zogu emërohet Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Brendshme.<sup>53</sup> Ai vijoi të avanconte procesin e stabilizimit. Në politikën e brendshme, Ahmet Zogu pati shumë sukses, krahasuar me të

<sup>53</sup> AQSH, F. 147, V. 1922, D. I-28, fl. 3.

gjithë qeveritë e mëparshme, duke shënuar disa suksese në stabilitetin e vendit.

Në pranverën e vitit 1922 u zhvillua një debat i ashpër politik në parlament rreth kohës së mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese. Përballë argumenteve të opozitës, që kërkonte mbledhjen e menjëhershme të Asamblesë Kushtetuese dhe përcaktimin e formës së regjimit, qëndronte mazhoranca, e cila, kishte parashtruar qëndrimet e saj për një shtyrje të Asamblesë për një periudhë relativisht të shkurtër. T. Selenica ka shkruar se, Statuti i Lushnjës mbledhjen e Asamblesë e kishte lënë mbas caktimit të kufijve politikë të Shqipërisë. “Tashmë kufit po caktoheshin, piramidat po nguleshin, komisioni nat e ditë po punonte e kështu shpresojmë për së shpejti të mbarohet caktimi i kufivet dhe të mblidhen gjithë zotrit e tokës shqiptare e t’i hedhin themelin e shtetit me konstitucionë që do të bëjmë.”<sup>54</sup> Ashtu siç kishte bërë shumica në debatet parlamentare, ai atakonte edhe kryengritjen e marsit, e cila ishte justifikuar nga opozita, si një kryengritje e nxitur nga nevoja e mbledhjes urgjente të Asamblesë Kushtetuese. “Për të vuë themelet e jetës politike të një shteti nuk mund të bahet assambleja nën grykën e pushkës e nën grushtin e influencën e disa vetave”, shkruante Selenica.<sup>55</sup>

Këtë koncept e mbështesnin pak a shumë edhe organizmat ndërkombëtarë. Në prill të vitit 1922, në një dokument me titull, “*Problemi konstitucional*”, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, raportonte: “Megjithëse, siç është deklaruar tashmë, qeveria aktuale është e vendosur të ndjekë rrugën e reformave, për momentin janë pak njerëz në jetën publike të vendit me eksperiencën dhe cilësitë personale të nevojshme për t’i vënë ato në praktikë.

Për më tepër, krijimi i qeverisë aktuale ishte rezultat i një situatë të jashtëzakonshme. Ajo u formua menjëherë pas zhvillimit të ngjarjeve revolucionare dhe Parlamenti i akordoi asaj fuqi të jashtëzakonshme për vendosjen e rregullit, si rezultat i së cilës njerëz me influencë janë akoma në mërgim”.<sup>56</sup> Këtë situatë, pra polarizimin e theksuar politik dhe konfliktualitetin në vend, ndonëse nuk e shprehte drejtpërdrejt,

<sup>54</sup> *Dit’ e re-Fletorja Zyrtare*, nr. 8, dt. 17 maj 1922, Teki Selenica, “Statut dhe Asamble Konstituante III”.

<sup>55</sup> *Po aty*, nr. 9, dt. 24 maj 1922, Teki Selenica, “Statut dhe Asamble Konstituante IV”.

<sup>56</sup> FO 371/8531, f. 035-041, Raporti përfundimtar i Komisionit të Hetimit në Shqipëri, J. J. Sederholm.

Komisioni e gjykonte si jo pozitive për të realizuar me sukses procesin tepër të rëndësishëm dhe të vështirë, të vendosjes së bazave solide kushtetuese të shtetit. Për këtë arsye, Komisioni kishte mendimin se, tashmë dukej e mundur që një Asamble Kushtetuese do të mblidhej “vjeshtën që vjen me qëllim për të caktuar formën përfundimtare të konstitucionit, por akoma nuk është e qartë nëse ka ardhur koha për të ndërmarrë vendime përfundimtare mbi këtë çështje”.<sup>57</sup>

Në fund komisioni jepte përfundimet dhe mendimet e tij në lidhje me formën e regjimit që i përshtatej më tepër vendit. Ai duke analizuar formën ekzistuese të regjimit pohonte në mënyrë kritike se, megjithëse “Shqipëria, në përputhje me Kushtetutën e përkohshme të Lushnjës ka një regjim parlamentar dhe një Regjencë me katër anëtarë, të cilët janë mbajtësit e pushtetit suprem; në fakt, pushteti i vërtetë qëndron në duart e qeverisë”. Kjo dëshmonte për mospërputhje brenda sistemit në peshën e institucioneve të ndryshme politike, në të cilat, në vend të Parlamentit, cilësohej si dominuese qeveria. Duke e përforcuar këtë qëndrim kritik ndaj sistemit politik të aplikuar deri atëherë në Shqipëri, Komisioni nënvizonte: “*Parlamentarizmi, në kuptimin përfundimtar të fjalës, me të drejtë vote të përgjithshme dhe direkte, nuk duket për momentin i përshatshëm për Shqipërinë, me popullsinë e saj heterogjene, e cila përfshin një shumicë të popullsisë analfabete dhe në të cilën forma e feudalizmit, është akoma mbizotëruese në një hapësirë të madhe.*” Komisioni Hetimor i LK mendonte se në këto rrethana ishte e nevojshme “*një qeveri qendrore e fortë, megjithatë, në të njëjtën kohë, duke iu lejuar provincave të ndryshme një farë administrimi lokal. Gjetja e balancës së duhur mes centralizimit dhe decentralizimit, do të jetë një nga problemet më të rëndësishme për shtetarët shqiptarë*”.<sup>58</sup>

Më këtë përfundim, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, kishte përmbledhur gjithë esencën e problemit konstitucional në Shqipëri, të cilit duhej t’i jepte një zgjidhje të përshatshme Asambleja Kushtetuese, që tashmë ishte projektuar të mblidhej.

---

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> Po aty.

*S u m m a r y*SOME ASPECTS OF THE ALBANIAN POLITICAL INSTITUTIONS'  
ACTIVITY DURING 1922

The political turmoil of December 1921 and, the parliament and government decisions that followed them, with regard to the organizers of the *coup d'état*, became a source of widespread discontent among the opponents of Zogu and although they had been moderate served as a reason for anti-government uprisings. The uprising of March 1922 was against a legitimate government which held a considerable majority in the parliament and was mainly encouraged by the limitless personal ambition of some leaders who wanted to seize power through violence and by neighboring countries' agents who aimed at causing instability. The appeal to gather the Constitutional Assembly was used as a political excuse to lead the country to early elections only a year after the elections had been held and a few weeks after the failed *coup d'état*. As a result, the political situation was unstable, whereas the International Commission of the Borders had not finished his work and the population had not been registered yet.

The political developments of 1921 put to the test all the state institutions established by the Congress of Lushnje. The most critical momentum was reached when two members of the Grand Council were dismissed and this constitutional body got into a crisis which showed that the political system established by the Congress of Lushnje had failed. The involvement of the Grand Council in the *coup d'état* and its consequences would cause a high level of tension between the political groupings in the parliament and outside it. Therefore, the leading institution of the state, instead of preserving political unity and cohesion in the country, which was its primary function, would become a mechanism for political confrontations and divisions that caused irreparable consequences. This institution would be responsible for the crises involving parliament and the parliamentary system in Albania during this period.

